

STATISTIKA TË PUNËSIMIT : ANKETA E FORCËS SË PUNËS
E BASHKIMIT EUROPIAN

Ana Franco
EUROSTAT

STATISTIKA TË PUNËSIMIT:
ANKETA E FORCËS SË PUNËS
E BASHKIMIT EUROPIAN

1. HYRJE

Çështja e punësimit mori një profil të theksuar politik brenda Bashkimit European gjatë vitit të kaluar dhe tani statistikat e punësimit qëndrojnë në thelb të politikave të Bashkimit European.

Një kapitull mbi punësimin u prezantua në Traktatin e Amsterdamin në vitin 1997 dhe në Këshillin e Jashtëzakonshëm European në Luksemburg në nëntor të vitit 1997, kryetarët e shteteve të 15 vendeve anëtare të BE, nënshkruan një strategji ambicioze europiane të punësimit. Kjo strategji bazohet në katër shtylla kryesore:

- përmirësim i aftësisë për t'u punësuar,
- zhvillim i sipërmarrjes,
- inkurajim i përshtatshmërisë,
- forcim i politikave mbi krijimin e mundësive të njëjta.

Për secilën nga këto shtylla disa tregues cilësorë dhe sasiorë u përcaktuan si thelbësorë në monitorimin e arritjes së disa objektivave politikë, të njohur si udhëzimet e punësimit. Shtetet anëtare i janë përkushtuar Strategjisë Europiane Të Punësimit duke zbatuar çdo vit Udhëzues të Politikës së Punësimit si edhe koordinimin e procesit të politikës së punësimit të përcaktuar në nenin 128 të Traktatit të Amsterdamin. Pikat kyçe të këtij procesi janë Planet Kombëtare të Veprimit, në të cilat Udhëzimet e Politikës Europiane të Punësimit të miratuara nga Këshilli, janë materializuar në politika kombëtare; Raporti i Përbashkët i Punësimit, ku progresi i zbatimit të strategjisë vlerësohet çdo vit, si edhe jepen rekomandime për drejtimin e politikave dhe të reformave strukturale të shteteve anëtare.

Një dialog konkret dhe konstruktiv nisi ndërmjet Eurostat-it dhe Direktoratit të Përgjithshëm të Komisionit për Punësim, i ngarkuar të çojë më tej udhëzimet e punësimit.

Politika ka për qëllim formulimin e udhëzimeve. Politika dhe statistika, së bashku, kanë për qëllim të zgjedhin treguesit e përshtatshëm, ndërsa statistika ka për detyrë t'i bëjë treguesit të vlefshëm.

Në këtë kontekst, roli i Anketës së Forcës së Punës së BE ka fituar vazhdimisht rëndësi dhe tani njihet universalisht si një mjet i pazëvendësueshëm në vrojtimin e zhvillimeve të tregut të punës si edhe në marrjen e masave të përshtatshme për të përkthyer strategjinë.

AFP është i vetmi burim informacioni në këto fusha, që mund të ofrojë të dhëna të krahasueshme në sensin e të qenit të pavarura nga korniza kombëtare administrative dhe ligjore. Ndërmjet instrumenteve statistikore të përdorura brenda BE, AFP është unike, për të përkthyer madhësinë e zgjedhjes, kohëzgjatjes që ofron, si edhe paraqitjes origjinale që ofron për zhvillimet ekonomike dhe sociale.

2. ANKETA E FORCËS SË PUNËS SË BE

2.1 ÇFARË ËSHTË ANKETA E FORCËS SË PUNËS SË BE

Një anketë e forcës së punës është një vëzhgim, që i'u drejtohet familjeve me qëllim që të mbledhë prej tyre informacion mbi tregun e punës dhe çështje të lidhura me të, nëpërmjet intervistave personale.

Anketa e Forcës së Punës së BE është krijuar duke bashkuar 15 AFP kombëtare, të hartuara nga shtetet anëtare. Një krahasueshmëri perfekte ndërmjet 15 shteteve është e vështirë të arrihet, edhe sikur të ishte realizuar një anketë direkte, që do të thotë që anketat të ishin realizuar në të njëjtën kohë, me të njëjtin formular dhe me të njëjtën mënyrë regjistrimi.

Pavarësisht nga kjo, niveli i krahasueshmërisë së rezultateve të AFP së BE është, dukshëm, më i lartë nga ai i shumë statistikave të tjera mbi punësimin ose papunësinë, që kanë në dispozicion shtetet anëtare. Kjo vjen si pasojë e:

- (a) regjistrimit të një grupi të përbashkët karakteristikash për të gjitha vendet;
- (b) një korrespondence të ngushtë ndërmjet listës së pyetjeve të hartuar nga BE dhe pyetësorëve kombëtarë;
- (c) përdorimit të përkufizimeve të njëjta për të gjitha vendet;
- (d) përdorimit të klasifikimeve të përbashkëta (për shembull, NACE për aktivitetin ekonomik);
- (e) përpunimit qendror të të dhënave nga Eurostat-i.

AFP e BE, megjithëse i nënshtrohet kufizimeve të BE mbi kërkesat për statistikat, është një përpjekje e përbashkët e shteteve anëtare për të koordinuar anketat e tyre kombëtare të punësimit, të cilat duhet t'u shërbejnë kërkesave kombëtare të çdo shteti. Për këtë arsye, pavarësisht nga koordinimi i punës ndërmjet instituteve kombëtare të statistikës dhe Eurostat-it, në anketë dallohen disa ndryshime nga njëri shtet tek tjetri.

Institutet kombëtare të statistikës janë përgjegjëse për zgjedhjen e madhësisë, për përgatitjen e pyetësorëve, për kryerjen e intervistave të drejtpërdrejta me familjet dhe për dërgimin e rezultateve në Eurostat në përputhje me skemën e përbashkët të dekodimit. Eurostat-i harton programin për analizën e rezultateve dhe është përgjegjës për përpunimin dhe për shpërndarjen e informacionit të dërguar nga institutet kombëtare të statistikës.

Pyetësorët janë hartuar në gjuhën kombëtare të secilit nga shtetet anëtare, duke marrë parasysh kushtet e parashtuara në rregullore. Për çdo karakteristikë të anketës të përmendur në rregullore, një pyetje ose një seri pyetjesh ekzistojnë në çdo pyetësor, që të mundësojnë këtë informacion të kalojë në Eurostat. Në rast të kundërt informacioni merret prej burimeve të tjera si për shembull regjistrat e popullatës.

Pyetësorët mund të përmbajnë pyetje të tjera, që nuk kanë lidhje me listën e karakteristikave në rregullore, por që pasqyrojnë një interes për temën e dhënë në nivel kombëtar. Duke u bazuar në madhësinë e zgjedhur, shifrat e përfuara shtrihen në nivelin e popullatës, zakonisht në bazë të faktorëve agregues të nxjerrë nga regjistrimi i fundit i popullsisë, duke bërë përshtatjet e duhura për të marrë në konsideratë ndryshimet, që mund të kenë ndodhur që nga koha e regjistrimit.

Hartimi i madhësisë i nënshtrohet disa kufizimeve, që rrjedhin nga rregullorja lidhur me nivelin e kërkuar të besueshmërisë statistikore dhe të përfaqësueshmërisë, të dyja në nivelin rajonal të NUTS II, si edhe me ndryshimet midis dy tremujorëve të njëpasnjëshëm. Brenda këtyre kufizimeve secili nga shtetet anëtare zgjedh formatin e vet të madhësisë dhe kryen intervistat.

2.2 HISTORIA DERI MË SOT

1960-1973 - Përpjekja e parë për kryerjen e një ankete të punësimit, që do të mbulonte Komunitetin Europian u bë në vitin 1960 nga 6 shtetet anëtare (Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg dhe Hollandë). Kjo përpjekje u konsiderua si një eksperiment dhe nuk u përsërit deri në vitin 1968, kur u realizua e para e një serie anketash të përvitshme.

1973-1981--Me zgjerimin e parë të Komunitetit Europian në vitin 1973, u fillua një seri anketash, që realizoheshin çdo dy vjet (apo dyvjeçare).

1983-1991-- Përkufizimet e përdorura në këto anketime të hershme ishin detyrimisht jo të sakta, për shkak të mungesës së një terminologjie të pranuar në rang ndërkombëtar. Ky boshllëk u mbush në vitin 1982 kur Konferenca e Trembëdhjetë Ndërkombëtare e Statisticienëve të Punës, e organizuar në Gjenevë nga Organizata Ndërkombëtare e Punës, miratoi një Rezolutë lidhur me statistikat e popullsisë, ekonomikisht aktive, punësimin, papunësinë, dhe nëpunësimin, duke përfshirë përkufizimet e sakta të kategorive të ndryshme të popullatës, që ishin objekt i anketave të punës. Shtetet Anëtare të Komunitetit Europian të atëhershëm ranë dakort të zbatonin këto rekomandime në një seri të re të Anketave të Forcës së Punës së Komunitetit, që do të realizoheshin çdo vit.

1992-1997-- Anketa vazhdoi të realizohej çdo vit, por, për herë të parë, u prezantua një kriter për besueshmërinë statistikore në nivel rajonal. Lista e ndryshoreve të mbuluara u rishikua dhe u zgjerua në mënyrë që të përfshinte tema të aplikueshme në Tregun Unik (si për shembull, lëvizshmërinë e forcës së punës ndërmjet shteteve), modele të reja të punës (punë në shtëpi, punë të dyta apo aktivitete të tjera ekonomike jashtë javës tradicionale 40-orëshe të punës) si edhe zhvillime të fundit në fushën e edukimit dhe të trainimeve profesionale.

Pyetjet lidhur me kërkimin e punës u korrigjuan në mënyrë që të konsideronin rekomandimet e ONP- së, sidomos duke zbatuar dallimin ndërmjet metodave aktive dhe atyre pasive të kërkimit të punës. Përkushtimi ndaj rekomandimeve të ONP-së siguroi një nivel të lartë krahasueshmërie ndërmjet rezultateve të marra nga kjo seri dhe atyre të përfuara nga anketat e viteve 1983 dhe 1991. Një rregullore e vetme, e përhershme zëvendësoi rregulloret e mëparshme që hartoheshin çdo vit.

2.3 KËRKESA TË REJA DHE NJË BAZË E RE LIGJORE

Në mes të viteve 1990 u morën në shqyrtim nevojat e të dhënave dhe u identifikuan kërkesat e mëposhtme:

-të dhëna të fundit mbi rritjen e punësimit për vlerësimin e masave strategjike dhe për përcaktimin e strategjive të tregut të punës;

-një vlerësim mesatar i përvitshëm i personave të punësuar duke marrë në konsideratë modelin sezonal të punësimit -- punë gjatë pushimeve, punë të bujqësisë, etj.;

-matje e volumit të përvitshëm të papunësisë duke marrë në konsideratë ndryshimet në modelet e punës me orar të pjesshëm;

-një kuptim më i qartë i marrëdhënieve ndërmjet pagës dhe llojeve të veçanta të punësimit si edhe i situatave të ndërmjetme midis punësimit me orar të plotë dhe papunësisë (në mënyrë të veçantë nën-punësimi i dukshëm);

-informacion mbi pjesëmarrjen në punë brenda një familjeje duke u bazuar në të dhëna më të plota mbi përbërjen e familjes në shqyrtim;

-të dhëna mujore të krahasueshme të papunësisë të varura më pak nga të dhënat ndihmëse prej regjistrave të papunësisë dhe më shumë nga rezultatet tremujore të anketës së forcës së punës.

Deri në njëfarë mase, kërkesat kombëtare për informacion statistikor nga anketa për forcën e punës, kanë rezultuar në përshtatje të formatit të anketës së lartpërmendur. Disa shtete anëtare po planifikonin të ndërmerrnin anketa më të shpeshta (një anketë tremujore me intervista të përsëritura është realizuar në disa shtete). Fatkeqësisht, këto inisiativa kombëtare nuk janë realizuar gjithmonë në të njëjtin drejtim, gjë që ka çuar në një bashkësi johomogjene të formateve të anketave kombëtare. Në mënyrë që të sigurohej përputhja e formateve, ishte e domosdoshme të hartohej një kornizë e përbashkët reference në bazë të së cilës do të ecej përpara në të ardhmen. Pas katër vitesh diskutimi me shtetet anëtare, u miratua një rregullore e re, e cila përcakton kryerjen në vazhdimësi të një ankete me objekt të përcaktuar, duke u lejuar në të njëjtën kohë shteteve anëtare të realizojnë vetëm një anketë vjetore, në pranverë në qoftë se ato e kanë të pamundur realizimin e një ankete të vazhdueshme.

Kjo rregullore e re u adoptua nga këshilli dhe u publikua në Gazetën Zyrtare Nr. L.77, 14-3-98, f.3 me numër 577/98.

2.4 NDRYSHIME TË PËRFSHIRA NË RREGULLOREN E RE

Mbulimi i popullatës dhe njësité e madhësisë

Kërkesa për përdorimin e familjes si njësi madhësie u hoq në mënyrë që të mos kufizoheshin shtetet, që preferojnë t'i bazojnë madhësitë e tyre mbi individët, me kushtin që kërkesat e tjera mbi familjen të plotësohen.

Anketa mbulon kryesisht persona, që banojnë në shtëpi private, por rregullorja e re propozon që, atje ku është e mundur, shtëpitë e përbashkëta të mbulohen me madhësi të hartuara posaçërisht për vëzhgimin e personave të marrë në shqyrtim. Në qoftë se kjo është e pamundur, personat në këto grupe, që vazhdojnë të mbajnë lidhje me një shtëpi private, përfshihen në analizën që i bëhet kësaj shtëpie.

Frekuenca e anketës

Ndërmjet viteve 1998 dhe 2001 një anketë e vazhdueshme e forcës së punës me rezultate tremujore dhe vjetore do të fillojë të zbatohet në shtetet anëtare të BE-së, përveç Gjermanisë dhe Austrisë ku kalimi nuk është caktuar akoma; në Gjermani disa anketa pilote do të realizohen në vitin 2000, por çdo vendim lidhur me kalimin në një anketë të vazhdueshme do të shtyhet deri në vitin 2005. Çdo tremujor përbëhet nga një bllok prej trembëdhjetë javësh, e para e të cilave nis më 29.12.1997. Britania e Madhe dhe Irlanda do të dorëzojnë të dhëna mbi bazën e tremujorëve sezonalë sipas kushteve të përfshira në rregullore. Javët e referencës janë shpërndarë në mënyrë të njëtrajtshme gjatë gjithë vitit.

Ndryshore

Disa ndryshore të reja u prezantuan në përbërjen e familjeve. Ky hap do të sigurojë informacion reciprok për individët dhe familjet, në mënyrë që të shqyrtohen modelet e sjelljes.

Matja e punësimit dhe e papunësisë është shtrirë në mënyrë që të përfshijë edhe matjen statistikore të nëpunësimit të dukshëm. Bashkësia e ndryshoreve të mbuluara në rregulloren "e vjetër" ishte e pamjaftueshme për zbatimin e interpretimeve të tanishme të nënpapunësisë. Për këtë arsye u prezantuan disa ndryshore të reja, që masin dëshirën për punë më tepër sesa numrin e orëve të punës dhe numrin e orëve që personi do të donte të punonte në total. Struktura e filtrave, gjithashtu, u ndryshua në mënyrë që të testonte nëse personat potencialisht të nënpunësuar janë aktualisht të gatshëm për të marrë ore shtesë pune.

Statusi i aktivitetit kryesor u prezantua si një ndryshore e re, që do t'u jepte personave të intervistuar mundësinë për të paraqitur perceptimin e vetvetes lidhur me statusin e aktivitetit të tyre; kjo ndryshore përmbush një kërkesë të ndryshme nga ato të plotësuara nga përkufizimet ndërkombëtare të forcës së punës. Për shembull, kjo ndryshore e re e identifikon studentin me një punë të vogël si më të gatshëm për ta shoqëruar veten me persona ekonomikisht joaktivë, sesa me persona të punësuar.

Moduli Arsim dhe Trainim u ristrukturua tërësisht në mënyrë që të plotësonte nevojat e reja: një mbulim më i detajuar i llojit të arsimit ose i trainimit të marrë gjatë katër javëve të fundit, gjatësia e trainimit dhe qëllimi i tij. Trainimi profesional është mbuluar, gjithashtu, më mirë dhe së fundmi është shtuar një ndryshore e fundit që tregon vitin kur është kryer me sukses niveli më i lartë i arsimit.

Një modul i ri për të ardhurat është prezantuar në mënyrë që të kuptohet më mirë lidhja ndërmjet pagave dhe llojit specifik të punësimit.

Programi i moduleve ad hoc mbi çështje të veçanta

Pyetëtori ka një strukturë modulare. Ai përbëhet nga 13 module, dy nga të cilat jo të detyrueshme, (të ardhurat dhe statusi kryesor) dhe një jo i detyrueshëm për tremujorët 1,3 dhe 4 (situata në vitin para anketës). Gjithashtu, një modul *ad hoc* mund të përfshihet në një tremujor për të cilin është vendosur kështu.

Moduli i parë *ad hoc*, është përfshirë në tremujorin e dytë të vitit 1999 dhe ka të bëjë me aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale. Tre shtete anëtare nuk ishin në gjendje të përfshinin këtë modul të parë *ad hoc* në pyetëtorët e tyre (Belgjika, Franca dhe Austria), një shtet mund të sigurojë vetëm informacion të pjesshëm (Gjermania), Suedia do të ketë si periudhë referimi tremujorin e parë dhe Italia të tretin. Ky modul përfshin ndryshore për aksidente në punë, që kanë ngjarë në 12 muajt e fundit si edhe probleme shëndetësore të lidhura me punën gjatë 12 muajve të fundit.

Një modul mbi kalimin nga shkolla në punë u përpilua në tremujorin e dytë të vitit 2000 dhe në vitin 2000 tema do të jetë gjatësia dhe modelet e punës.

Afati për dorëzimin e rezultateve

Shtetet anëtare duhet t'i dërgojnë Eurostat-it rezultatet tremujore të anketës së vazhdueshme brenda 12 javësh pas fundit të tremujorit, që është marrë si referencë.

Për shtetet, që nuk janë në gjendje të realizojnë një anketë të vazhdueshme, vonesa për kalimin e rezultateve është 9 muaj pas përfundimit të periudhës, që është marrë si referencë.

2.5 BAZA LIGJORE

Anketat më të hershme të forcës së punës për Komunitetin nuk ishin zyrtare, por, që nga viti 1973 e tutje, Këshilli i Ministrave që drejton funksionimin e anketës miratoi një rregullore. Çdo rregullore aplikohet për anketën e një viti të veçantë, deri në anketat e viteve 1990 dhe 1991, të cilat u përfshinë në një rregullore të vetme (rregullorja e këshillit (EEC) N^o 3044/89) e cila mbeti në fuqi deri sa u zëvendësua nga legjislacioni i ri.

Në vitin 1998 u adoptua një rregullore e re (rregullore e këshillit (EEC) N^o 577/98).

Artikulli 4.3 i kësaj rregulloreje parashikon që përkufizimet, redaktimet që do të përdoren, kodifikimet e ndryshoreve, rregullimi i listës së ndryshoreve të anketës, që u bë i nevojshëm si pasojë e evolucionit të

teknikave dhe të koncepteve, dhe një listë e parimeve për formulimin e pyetjeve lidhur me statusin e punës, nxirren pas një konsultimi dhe marrëveshjeje me Komitetin e Programit Statistikor. Komisioni duhet t'i adoptojë këto vendime sipas formës së rregulloreve të komisionit duke zbatuar rregulloren nr. 577/89 të këshillit. Që atëherë, janë adoptuar 7 rregullore të komisionit të këtij lloji:

-Rregullore e Komisionit n0 1571/98, datë 20/7/1998:

- përkufizimi i tremujorëve referencë,
- programi i moduleve *ad hoc* 1999-2000,
- listë e detajuar informacioni për t'u mbledhur në modulën *ad hoc* të vitit 1999,
- kodifikimi që do të përdoret në vitet 1998 dhe 1999;

-Rregullore e Komisionit n0 1924/1999, datë 8/9/1999: -Programi i moduleve *ad hoc* i viteve 2000-2002;

-Rregullore e Komisionit n0 1925/1999, datë 8/9/1999: -Listë e detajuar informacioni për t'u mbledhur në modulën *ad hoc* të vitit 2000;

-Rregullore e Komisionit n0 1575/2000, datë 19/7/2000: -Kodifikimi që do të përdoret nga viti 2001 e tutje;

-Rregullore e Komisionit n0 1626/2000, datë 24/7/2000: -Programi i moduleve *ad hoc* për vitet 2001-2004;

-Rregullore e Komisionit n01578/2000, datë 19/7/2000: -Listë e detajuar informacioni, që do të mbledhet në modulën *ad hoc* të vitit 2001;

-Rregullore e Komisionit n0 1897/2000, datë 7/9/2000: -Përkufizimi i ri i papunësisë dhe parimet për formulimin e pyetjeve mbi statusin e punës.

2.6 PËRMBAJTJA E ANKETËS

Lista e ndryshoreve të pranishme në AFP dhe në BE mbulon informacion jo vetëm mbi karakteristikat e punësit bazë, por edhe mbi të punësuarit në më shumë se një punë, të papunësuarit dhe personat ekonomikisht joaktivë. I gjithë ky informacion mund të ndërthuret me mjedisin demografik, nivelin e arsimit, përbërjen familjare apo situatën e një viti më parë. Lista e mëposhtme numëron ndryshoret e anketës dhe jep një përshkrim të përgjithshëm mbi informacionin e mbledhur. Më tepër detaje përfshihen në publikimin "Anketa e Forcës së Punës - Metoda dhe Përkufizime, Edicion i vitit 1998".

Mjedisi demografik:

- numri rendor në përbërjen familjare,
- seksi,
- viti i lindjes,
- data e lindjes në lidhje me fundin e periudhës së referencës,
- gjendja civile,
- lidhja me personin e referencës,
- numri i sekuencës i bashkëshortit/es,
- numri i sekuencës i babait,
- numri i sekuencës i nënës,
- kombësia,
- numri i viteve të rezidencës në shtetin anëtar,
- shteti i lindjes (i padetyrueshëm),
- natyra e pjesëmarrjes në anketë (pjesëmarrje direkte apo autorizim nëpërmjet një anëtar të familjes).

Statusi i punës:

- statusi i punës gjatë javës së referencës,
- arsyeja që i intervistuari nuk ka punuar edhe pse është i punësuar,
- kërkimi i punës nga personi i papunësuar,
- lloji i punës që kërkohet (vetëpunësim apo i punësuar nga dikush tjetër),
- metodat e përdorura për gjetjen e punës,
- gatishmëria për të filluar punë.

Karakteristikat e punës kryesore:

- statusi profesional,
- aktiviteti ekonomik i njësisë lokale,
- lloji i punës (okupacioni)
- numri i personave të punësuar në njësinë lokale
- shteti i vendit të punës,
- rajoni i vendit të punës,
- viti dhe muaji kur personi filloi punën në punën aktuale,
- qëndrueshmëria e punës (dhe arsytet),
- kohëzgjatja e punës së përkohshme ose kontratë pune me kohëzgjatje të kufizuar,
- dallimi ndërmjet punës me orar të plotë dhe asaj me orar të pjesshëm (dhe arsytet),
- puna në shtëpi.

Sasia e punës së kryer në orë:

- numri i orëve të punës së kryer në një javë,
- numri orëve të punës së kryer,
- arsyet kryesore që orët e punës së kryer aktualisht, ndryshojnë nga orët që duhej të ishin plotësuar.

Puna e dytë:

- ekzistenca e më shumë se një pune,
- statusi profesional,
- aktiviteti ekonomik i njësisë lokale,
- numri i orëve të punës së kryer.

Nënpunësimi i dukshëm:

- dëshirë për të punuar, zakonisht mbi numrin aktual të orëve të punës (i padetyrueshëm në rastin një ankete vjetore),
- kërkimi për një punë tjetër dhe arsytet,
- lloji i punës që kërkohet (si i punësuar apo i vetëpunësuar),
- metodat e përdorura për të gjetur punë tjetër,
- arsyet përse një person nuk po kërkon një punë tjetër (i padetyrueshëm në rastin e një ankete vjetore),
- gatishmëria për të filluar punë,
- numri i orëve të dëshiruara të punës (i padetyrueshëm për anketë vjetore).

Kërkimi për punë:

- lloji i punës që kërkohet (punë me orar të plotë apo të pjesshëm),
- kohëzgjatja e kërkimit të punës,
- situata e personit menjëherë para se të fillonte të kërkonte punë,
- regjistrimi në zyrën e punësimin publik dhe përfitimi nga kjo zyrë nëse ka patur të tillë,
- dëshirë për të punuar nga ana e personave që nuk kërkojnë punë,
- arsyet pse persona të tillë nuk kanë kërkuar punë.

Arsimi dhe trainimi, pjesëmarrja në arsim ose në trainim gjatë katër javëve të mëparshme:

- qëllimi,
- niveli,
- lloji,
- kohëzgjatja e përgjithshme,
- numri i përgjithshëm i orëve,
- niveli më i lartë i arsimit apo i trainimit të përfunduar me sukses,
- kualifikimi profesional në nivelin universitar i të intervistuarit.

Ekspierencë e mëparshme pune e personit të papunësuar:

- ekzistencë e ekspierencës së mëparshme të punës,
- viti dhe muaji në të cilin personi punoi për herë të fundit,
- arsyet që personi la punën apo biznesin e fundit,

E																				
F																				
IRL																				
I																				
L																				
NL																				
A																				
P																				
FIN																				
S																				
UK																				

Tabela 3. Disponueshmëria e të dhënave për AFP për vendet që nuk bëjnë pjesë në BE - të dhëna tremujore (kutizat gri tregojnë që të dhënat janë të disponueshme).

	96 q1	96 q2	96 q3	96 q4	97 q1	97 q2	97 q3	97 q4	98 q1	98 q2	98 q3	98 q4	99 q1	99 q2	99 q3	99 q4	00 q1	00 12	
IS																			
NO																			
CH																			
CZ																			
EE																			
HU																			
LT																			
LV																			
PL																			
RO																			
SI																			
SK																			

3 INFORMACION NGA INTERNETI MBI TREGUN E PUNES DHE STATISTIKA TË TJERA SOCIALE.

Eurostati ka një faqe me akses të lirë (<http://europa.eu.int/comm/eurostat>), që rinovohet çdo ditë në orën 12:00 CET. Në këtë faqe ju mund të gjeni:

- informacionin më të fundit dhe më të plotë statistikor mbi BE dhe zonën e Euros;
- një sistem miqësor ndaj përdoruesit të kërkimit në internet;
- shërbime online nëpërmjet të cilave mund të përpunoni kërkesat tuaja.